



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 6 nëntor 2015, në mbledhjen XVIII – të (tetëmbëdhjetë) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.05'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmeti, kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Bahri Selimi, z. Mefail Rama,, z. Shaban Osmani, z. Radisav Perović.z, Xhafer Ademi dhe z. Xhevdet Beselica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Halit Vërshevci, shef i Sektorit të Shëndetësisë në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Fadil Babatinca, Policia e Kosovës, Enver Ajeti, Policia Kufitare, Skender Shatri dhe Bekim Karaxhija OSBE.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 29 shtator 2015

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Shqyrtimi i mundësive për ofrimin e ndihmës në dru për ngrohje për familjet e komuniteteve RAE me gjendje të rëndë sociale

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Shaban Osmani, theksoi, në radhë të parë është mirë të informohemi se a është bërë kërkesë në Drejtoritë përkatëse për ofrimin e ndihmës në dru për ngrohje për familjet e komuniteteve RAE me gjendje të rëndë sociale dhe nëse është bërë kërkesa cila është përgjigjja, mirëpo nëse nuk është bërë kërkesa ne

në këtë mbledhje mund të miratojmë një rekomandim dhe të njëjtin t'ua dërgojmë Drejtorive kompetente.

Përndryshe për dru për ngrohje ka nevojë një numër i konsiderueshëm i familjeve të komunitetit shumicë por sigurisht në gjendje të rëndë janë edhe disa familje të komuniteteve RAE, mirëpo duke u bazuar në mungesën e buxhetit për këtë destinim propozimi im është që nga familjet e komunitete RAE të bëhet lista e familjeve me gjendjen më të rëndë dhe të shikohen mundësítë përfurnizim me së paku 2 m^3 dru për ngrohje.

z. Halit Vërshevci, shef i Sektorit të Shëndetësisë në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, theksoi, një numër i konsiderueshëm i familjeve të komunitetit shumicë janë në gjendje të rëndë sociale e këtë e dëshmon fakti se mbi 1000 familje janë në asistencë sociale, mirëpo pajtohem plotësisht me konstatimin e paraqitur në këtë mbledhje se edhe një numër i familjeve të komuniteteve RAE janë në gjendje mjftë të rëndë sociale.

Sa i përket çështjes për të cilën po debatohet tani për tani nuk mund të them asgjë konkrete por mbetet që në kuadër të Drejtorisë të shqyrtohen të gjitha mundësitë për ofrimin e ndihmës në dru për ngrohje.

z. Xhafer Ademi, theksoi, po ndërlidhem me diskutuesin paraprak dhe kërkoj që në kuadër të 1000 familjeve që janë në asistencë sociale të përfshihen dhe të mos anashkalohen familjet e komuniteteve RAE ngase herëve të tjera ka ndodh që në listën e Qendrës për Punë Sociale nuk është përfshirë asnjë familje e komuniteteve RAE.

z. Halit Vërshevci, theksoi, Qendra për Punë Sociale është institucioni që e bënë listën e familjeve të cilat kanë nevojë për ndihmë në dru për ngrohje ngase e njëjtë është në lidhje të drejtpërdrejtë me familjet e kategorisë së cekur dhe shtoi, për çështjen të cilën e ngriti parafolësi nuk kam informacione por ndoshta është bërë ndonjë lëshim ngase Qendra për punë Sociale e shqyrton gjendjen e të gjitha familjeve që janë në asistencë sociale pavarësisht përkatësisë etnike.

Sa i përket çeshtjes se anashkalohen familjet e komuniteteve RAE një konstatim i tillë nuk është i qëndrueshëm ngase edhe z. Xhafer Ademi është në dijeni se Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale çdo herë ka ofruar ndihmat e mundshme, e rikujtoj të përmendurin se kjo Drejtori ka ofruar ndihmë edhe në mënyrë urgjente siç është rasti për një fëmijë të sëmurë.

z. Faik Gashi, shef i Zyrës ligjore, theksoi, konsideroj se është e nevojshme të jepen sqarime për çështjen e ngritur nga z. Xhafer Ademi ngase konstatimi i paraqitur është skajshmërisht i kundërt me realitetin, është fakt se disa vite me radhë Komuna ka dhënë ndihmë në dru për ngrohje dhe shumë herë është përmendur se komunitetet RAE, që janë 07% apo 08%, jo vetëm në rastin e ndihmave në dru për ngrohje por edhe në rastet e ndihmave të tjera kanë qenë përfituese së paku 10% nga numri i përgjithshëm e kjo mund të dëshmohet mbi bazën e dokumentacionit përkatës.

z. Xhafer Ademi, theksoi, pajtohem me parafolësin por si duket jam keqkuptuar ngase unë nuk thash se nuk kanë marrë ndihma por thash se janë bërë lëshime.

z. Faik Gashi, theksoi, gjatë diskutimit duhet pasë kujdes çfarë flitet ngase diskutimi çfarëdo qoftë përfshihet në Ekstraktin e procesverbalit.

Në mbledhjen e kaluar për çështjen e regjistrimit të nxënësve të kthyer nga diaspora, z. Xhafer Ademi ka thënë se më keni keqkuptuar tash sërisht po thua se

je keqkuptuar, por mbledhja regjistrohet dhe mund të verifikohet diskutimi i çdonjërit.

z. Bahri Selimi, theksoi, kjo çështje është shtuar në rend dite me qëllim që të ndihmohen komunitetet pakicë me dru për ngrohje, mirëpo konsideroj se ne paraprakisht duhet të kemi informacione për sasinë e druve që është në dispozicion për shpërndarje dhe në bazë të kësaj mundemi të përcaktohem për sasinë që do t'i ndahet komuniteteve pakicë dhe sasinë e cila do t'i ndahet komunitetit shumicë kur dihet se mbi 1000 familje janë në asistencë sociale.

Gjithashtu jemi në dijeni se komunitetet pakicë në përqindje janë numër i vogël por gjithherë janë bërë lëshime duke e ditur se komunitetet RAE janë në gjendje të rëndë sociale.

Përndryshe jemi në dijeni se ky Komitet nuk mund të merr vendim por mundet vetëm të miratoj rekomandim qoftë Kuvendit apo Drejtorisë përkatëse.

z. Mefail Rama, theksoi, nuk pajtohem me atë që po diskutohet se komuniteteve pakicë ju takon kjo apo ajo përqindje në aspektin e ndihmave ngase unë të gjithë qytetarët e Komunës i konsideroj të barabartë. U përmend se në asistencë sociale janë mbi 1000 familje dhe jam i mendimit se prej kësaj kategorie duhet të përzgjidhen rastet me gjendje sociale më ekstreme, pra ndihmë në dru për ngrohje t'i ndahet familjeve që vërtetë kanë nevojë të madhe.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi, Komuna çdo herë kur ka ndarë ndihma të ndryshme në të gjitha rastet dhe i ka pasë në konsideratë komunitetet RAE, andaj për këtë çështje nuk kemi çfarë të diskutojmë, por për rastin konkret unë propozoj që Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, t'i rekomandohet që të shqyrtoj mundësitë për ofrimin e ndihmës në dru për ngrohje disa familjeve me gjendjen më të rëndë sociale.

Propozimi i kryesuesit u miratua njëzëri.

4. Të ndryshme

z. Bekim Karaxhija, përfaqësues OSBE – së, theksoi, Komuna e Podujevës në vazhdimësi ka raportuar sa i përket ndihmave të ofruara në veçanti për komunitet RAE, pra koj çështje është e qartë për të gjithë ne dhe për këtë konsideroj se nuk është i nevojshëm kurrrfarë debati.

Pastaj shtoi, ne në vazhdimësi jemi në kontakt me Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Zyrën ligjore të Komunës dhe në bashkëpunim me Departamentin e OSBE – së për organizimin e trajnimeve për polici dhe siguri në bashkësi, Departament i cili ka paraqitur nevojën se në rajonin e Mitrovicës, sipas organizimit territorial të OSBE – së, në Policinë e Kosovës ka mungesë të përfaqësuesve të komuniteteve RAE dhe ka ardhur në përfundim që për konkursin e radhës me i inkurajuar pjesëtarët e komuniteteve të cekura dhe me organizuar një trajnim të specializuar për përgatitjen e kandidatëve përkatës. Në rajonet e tjera trajnimet e cekura në bashkëpunim me Policinë e Kosovës kanë rezultuar të suksesshme. Në këtë kontekst kësaj radhë është vendosur që dy pjesëtarë të komuniteteve RAE të marrin pjesë në trajnimin katër ditor që do të mbahet në Mitrovicën e Veriut, do theksuar se siguria është e plotë. Emrat e kandidatëve janë dërguar dhe të njëjtit do të ftohen me kohë për pjesëmarrje në trajnim.

Shpenzimet e trajnimit i bartë OSBE me përjashtim të transportit deri në Mitrovicën Jugore, transport që Komuna është zotuar se do ta siguroj.

z. Xhafer Ademi, theksoi, në lagjen "Ali Ajeti" ka qenë një sasi shumë e madhe e mbeturinave që kanë paraqitur rrezik përrhapjen e ndonjë epidemie, dhe në bazë të kërkesës tonë, Drejtoria përkatëse i ka ndërmarrë masat e nevojshme dhe dy herë i ka larguar mbeturinat e cekura, por herën e tretë largimin e mbeturinave e kemi organizuar në bashkëpunim me Kryqin e Kuq.

Mbledhja përfundoi në orën 11.45'.

Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi

Nr. 01-006- 100202
Podujevë,
6 nëntor 2015

Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti